

# Faik Deda

BIBLIOTEKA

BSH-1

D32

*Fjalë  
që na i fshehu deti*

POEZI

8SH-150

D 32

Fjalë  
që  
na i fshehu  
deti

Poezi

FAIK DEDA



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»



## PËRROI

Ai rrjedh pareshtur në po atë udhë.  
Ndër rrëkeza,  
Fjalë djalërie që i ndiej veç unë  
Dhe ai vetë.

Pëshpërit nën buzë,  
Diku buçet  
E rrugën humb.

E kam dashur kur ka qenë sherret,  
I jam truar

— kur ka qenë pëllumb.

## TË KISHA PRITUR TY

Shohim yjet e ndezur që s'ua mësuam dot  
emrat.

E, megjithatë  
ndiejmë mall.

E dimë që po dalin dhe presim,  
Nëpër muzgjet e ditëve.

Kështu m'u shfaqe ti,  
Dhe harrove të ikje...

## ÇMALLJE

Aromë tërfili, lule bliri edhe hije,  
Cicërimat e gushëkuqit majë një plepi;  
Pas kaq vjetësh vij të gjej gjurmët e tua,  
Të ndiell aromën tënde, Feraseti...

Sa kohë u bënë që më nuk jemi parë,  
Sa shumë na kanë pritur këto pemë;  
Pa, duket sikur thonë: — Ejani prapë,  
Se ne u ngritëm lart që...  
t'ju gjejmë!

## TREGIM I NJË NËNE PËR LUFTËN...

Armiqtë na rreshtuan në buzë të lëmit,  
Na rrëmbyen mandilet nga koka,  
Na shkulën vathët në veshë.

Drithërimë ndjeu toka,  
Balli na u rrudh  
Po, fytyra  
s'na u zverdh.

## ZAMBAKËT E LIRIKAVE

— Zef Serembe —

Derdhen elegjitë, thinjur ndër thëllime,  
Ndezur mall në gji, ai kujton vendlindjen...  
Vargjet e përmendin dhe çalltis prej gjumit,  
Si ta harrojë vendin, ndonëse detesh humbi?!  
Dallga është e sertë, dhimbja kaq e thellë,  
Ra një gjethe i blertë, era po e merr...

Herë me mërmërimë valëza nis adetin,  
Herë me tërsëllimë zë e gjëmon deti;  
Nga qerpik' i shpresës loti-sumbull del,  
—Gjethin e harresës, ku e çon, moj erë?!

Brofi zemr' e lodhur, dallgë malli nisi,  
— Vallë, ç'ti ketë ndodhur? Gjoksi pse  
dalldisi?!  
Pse me drithmë u drodh shpirti i poetit?  
Valëza që s'lodhet, ç'i mërmëron detit?



Ç'djepe tund ndër duar deti i rrëmbyer,  
Mijëra të mërguar, vallë do kenë të kthyer?!

Dallgët uturojnë, brof një mall i rëndë,  
Sytë lot lotojnë për nga toka-mëmë...  
Nis ushton nga fundi deti me tallaz,  
...Lirikat ku humbën? Ç'dallgë po i përplas?!  
Nëpër valë-pasqyrë ca lirika dridhen,  
Zambakët e tyre mbijnë nëpër brigje...

Ja, pakëz lirika... shoqet lënë gjith' mall,  
Zemrat tona ngrohen tek i bien valët!...  
Buzagaze vijnë, lodrojnë buz' zallit,  
Për brigjet ku lindën zën' pikojnë mallin...  
Gjaku pika-pika rrjedh nëpër damarë,  
Të tjerat lirika, ç'dallgë t'i ketë marrë?!

...Thonë i humbën tutje? Dalgë, ç'ia bëtë  
poetit?!  
— Shihni: U bënë lule në atdhe, bregdetit! ...  
Keni parë ca lule mbirë përmbi rërë?  
Janë të Zef Sërëmbes; ulni pakëz zënë...

## QIELLI

Rrimë sa rrimë,  
Vemi nga vemi,  
E ngremë kokën lart.

I pafund  
    ky mur,  
Me ajër e yje...

Ç'ëndërronim dikur,  
Sot, ndodh  
Të mos ua besojmë as syve.

## STINA E JETËS

Bulojnë sythet,  
Bien gjethet,  
Ndërrojnë stinët,  
Ujërat —  
Herë mpaken e,  
shtohen herë tjetër.

Njerëzit,  
Ndonëse jo të përjetshëm, —  
Farkëtues  
Të dritës,  
të hijes,  
të së gjelbrës.

E gjelbër ngaherë

— Veç pema e jetës.

## KROI I VETMUAR NDANË XHADESE

1'

Ky perëndim kështu i çuditshëm,  
Me kaq skulptura të përkryera resh që  
s'levizin,  
Nga më të ndryshmet forma praruar prej  
diellit.

2

Vështroj lëkundjen e një kurore peme,  
Përkunden nga era gjethet valë-valë,  
Rrënjët gëzimmëdha të asaj peme mendcj. . .

3

Të kacavjerrura degët e një rrushi të egër  
Lartësive të një vidhi hijegjërë.  
Vreshta me rrush e me kujtime ndodhet diku  
larg.

4

Lisa të gjatë buzë bregut bëjnë hije,  
Hieja e tyre ecën në pasqyrëzat e valëve,  
Në qetësi lumi pret shirat e verës që kaloi.

5

Zallishtja e lumit me gurët e bardhë,  
Përsipër gurëve myshku i hershëm,  
Myshku i kujtimeve në trungjet e lisave aty  
pranë.

6

Nuk janë njëlloj degët e një peme,  
Njëlloj s'përkunden gjethet nga era,  
Aroma e gjetheve mbart gjuhën e rrënjëve.

7

Mërmëron kroi i vetmuar ndanë xhadesë,  
Udhëtarët vijnë e ikin kohë pas kohe,  
Kroi dhe një lis s'bëhen merak për asgjë.

## LIRIKAT E LIQENIT

Lëpihen valët bregut, me nxitim,  
Qetohen pranë gërshetave të tua.  
— Qëndroni, valë, kini pak durim,  
Dhe merrmëni me vete edhe mua...

Te kurmi yt i brishtë, pa ngurim  
Të bëhem valë  
dhe, gjë tjetër s'dua!...



## PRANVERË E VONUAR


Fërfëron një panjë mbi arrishte,  
Shelgjet varën flokët mbi përrua.

Humbi gjurm' e vjetër në zallishte,  
Vetëm un' kujtoj atë që dua...

Ku t'i gjej prapë vitet që më vanë?  
Kohën blu, që ndjell dashurinë?

Ngrohtësinë e saj si ta sjell pranë,  
Kur mbi panjë

të tjerë zogj cicërijnë!...



## TRIMËRESHA MARO KONDA

— *Hiqma udhën, kaproll mali,  
Ja, në thikë dhe ty, dhe djalin!...*

Ngjitej llohërash majë më majë,  
Buzë rrufeve iu kreh shtati;  
Vetëtinte fjal' e saj,  
Ç'i kish aq lezete hapi...  
Faqe shpatit, atë ditë  
Foshnja gjoksit s'iu përmënd;  
Mes puhisë qetaz flinte,  
Një bucelë varej mbi këngë...

Pas saj lidhur dhjetë firoma,  
Një vargan drejt majës së malit;  
Syshkëndijë Maro Konda,  
Shtegu sa një thundër kali.  
Mori zvarrë me rrokullimë  
Dhjetë asqerë, sa dhjetë biga;  
Zogjtë ndalën ligjërimin,  
Dhjetë sorra zgjoi frika...

Sorrat ranë mbi një luginë,  
Po s'u qasën tek një pllakë;  
Pllaka mbante në pëqi,  
Mëm' e bir qafuar bashkë...  
Veç aherë diç foli foshnja,  
Nëpër ëndrrën krahëflutur;  
Donte gji a ç'desh të thosh  
Sipër gjinjve gjak të bukur?...

Thellë në hon një ledh i vogël,  
Ç'i mbështolli që të dy;  
Nëna-shqipe, djali-zog,  
Fërfëron ëmbël një bli...  
...Vijnë nga pllaja blegërima,  
Kënga zë puthet me retë;  
Krojet thonë mes shushurimash:  
— Shëëët, se foshnja po fle qetë...

## TRE VËLLEZËRIT FRASHËRI

Mëmëdhe, o besë e prag,  
Dhe në dhé ç'do kemi mall;  
Prehje te kjo tok' e largë,  
S'kemi, dhe në paçim varr.

Na vëlon ky gjoksi flakë,  
S'ka të çlodhur kurrë ky shpirt;  
Shpat' e Gjergjit feks në natë,  
Shpatë me tehun larë dritë...

Plag' e plumba s'dinë të ndalur,  
Halleshumët nëpër mote;  
Retë me thembër i ka sprapsur  
Toka jonë Kastriote.

## MOT I VRENJTUR

Togje stërmëdhaja  
Nëpër qiej bredhin;  
Erërat i palosin,  
I shtyjnë, i mbledhin...

Posht' atyre pirqjeve,  
Rrinë majat me borë;  
Vrapojnë shtëllunga  
Me shtëmba në dorë...

Ndiej një hap të largët,  
Ja, sikur merr udhë...  
Unë mendoj atë:  
— Vallë, u nis tek unë?!...

## DËSHMORI QË RA NË DITËN E ÇLIRIMIT

*Nazmi Dervish Hasanit, rënë më  
29 Nëntor 1944*

Sipër borës së bardhë buzëmbremja flakë,  
Atë çast kur ndanë shtëpisë mbërriti korrieri.

Përroi sikur rridhte më me pak,  
Gjëmonte së thelli.

I përgjakur dhe agimi,  
Në ditën e madhe  
të më të madhes ëndërr...

Pjergulla ndjeu ngrohtë sofateve të gëzimit,  
Lëshoi një degëz mbi ballin e nënës.

Qetoi pakëz era e xixëlluan yjet,  
Diç po thoshin shëlgjet e rrahur nga shiu.

Jehona isosh sillnin lehtëzi pyjet,  
Sikur këndonte Nazmiu...

## KU TA KËRKOJ?

Duke zbritur brezareve,  
Loz e loz me mbrëmjen,  
Luledardhave brufëroi gjith' mall.

Ai zogu i bukur  
i syve të saj  
Më hyri në zemër.

Dolën yjet  
po ku shkoi hën' e bardhë  
E atij vështrimi t'ëmbël?



NËNA E DËSHMORËVE  
LEF E MITAQ SALLATA

Bie muzgu e me muzgun  
shtigjet shtojnë erën,  
Fëshfërijnë pemët në çdo anë.

Ja, dhe pak e ngadalë do shtojnë derën  
Lefi me vëllanë.

Do shtojnë derën e me një këngë në buzë  
Do hyjnë brenda.

Kanë bërë kaq udhë  
Po, druhen  
mos zgjohet nëna...

## GJITHKUSH GËZOHET

I gëzohen njerzit —  
Livadhit të qetë në një rrjedhë burimi.  
Manushaqeve të sapoçelura buz' agimit,  
Gurgullimës së ujërave nëpër gurët e bardhë,  
Kodrave qëndisur brezare tejendanë,  
Gjelbërimit të bimëve që mbajnë gjallë jetën,  
Isos së turbinave që derdhin ngado dritën,  
Hijes ngrohtërore të ullinjve të përjetshëm,  
Lëvizjes gëzimshumë që pret e përcjell ditën...

Dhe ecin njerzit mes ngazëllimit që nuk  
resht,  
Bien në mendime e mendimi s' rri rehat;  
Drejt shtigjesh të reja një çast s' di të hesht,  
Gjokset mbush me vrull  
si pema frutin mjaltë. . .

## MARRËVESHJE

Trok' i mallit rend e rend  
gjurmëve të një dreri,  
Përtej cicërimash,  
sa pa shaluar maleve mbrëmja...

Gjithçkaje të gëzueshme i gëzohen njerzit,  
Gjithkujt —  
dikë krejt veças ia do zemra,  
Ia ndien zërin, e kërkon me sy...

Unë dua këngën,  
agun  
dhe ty.

## PËR KËTO TROJE

*«...kaptoi nëntë male me radhë,  
hakën nuk e la pa marrë...»*

Hasmi ra si miza bletës  
Mbi çdo derë e në çdo shteg;  
Po tek ne farën e jetës  
Malet e mbajnë në thelb.  
Vetëm krojet s'morën flakë,  
Ç'ma përvëluan kasollen;  
Dergjej nëna atë natë.  
Hir' i saj — ku më ndodhet?!

...Sikur zu të pritet era.  
Ti, puhizë, çfarë më thua?  
Motër moj, dilmë te dera,  
Flokët mos i pre për mua.  
Unë po shkoj për tek taborri,  
Një nga një me thikë t'i pres.  
— Nënë moj, malli ç'më poqi,  
Mallin dheu s'do ta tresë!...

Çlodha krojeve i dirsur,  
Pas me një grusht deli trima;  
S'jemi lepuj të gremisur  
Po gatuan suferinash.  
Gjoks përgjakur me kaq hije,  
Thembra jonë lëshon çika;  
Kujt në qafë neve na bie,  
M'u nën qafë i ngulet thika.

## BUZË ME MBRËMJEN

Ti ecje ledheve të mbrëmjes  
E nëpër brigjet e një kënge...

Drita e vështrimit tënd  
Bënte të dridhej  
Nga gëzimi i tejdukshmërisë  
pikën e vesës.

Ndonëse dita ish më t'errur,  
Sikur kish rënë mëngjes.

Mbi petalet  
E bajames së porsaçelur  
Pikonte vesë.

Vesë. . .

## KJO UDHË NËPËR NATË

Portokalle e Himarës moj, tërë këtë natë  
Ti noton e pasqyrohesh ledh më ledh;  
Po bën udhë e krihesh

nga kjo hën' e artë,  
Majë gishtash në hapësirën buz' detit...

Del nga kaltërsia e qiellit që me majat puthet,  
Faqet për t'i njomur

tek vala ndanë shkrepit;  
Ty në degë limoni ç'të preken baluket,  
Syri im te hapi yt më mbeti...

Më e bukur ti a... më i bukur deti?

## NE KËTË MËNGJES TË FRESKËT

Ka diçka që s'njeh të këputur,  
Tek ecim dorë për dorë.

Çelen lulemollët,  
shih  
sa bukur!

Ato bëhen edhe mollë.

Mollë...



4 SHKURT 1944

Të gjitha dihen e  
                    asgjë koha s'mundet ta harrojë.  
Po, se ç'm'u kujtua fat' i një foshnje pas-  
  mesnate,  
Si ia shkulën sytë me thonj  
Tek gjirit të s'ëmës  
                                    s'i ndahej.

S'ka më vështirë se të shkulësh dy sy aq lehtë,  
Dy sy të veckël,  
Kryebukuria  
                    e bukurisë së një foshnje!...

Ata sy kishin dritë...  
Mund të shkulej dhe dielli si dy sytë?!

## NUK MUND TA PUSHOJ KËNGËN

I

Majë malit shkëmb' i thepisur me dy maja,  
Në këmbë të malit rrjedh lumi,  
I pëshpërit pylli me gjuhën e valëve shkë-  
mbit. .

2

Kjo majë mali si e qëruar me dorë,  
Gurëz të vegjël, lule të vogla,  
Delja e mallit tim kullot barin për çdo stinë.

3

Vështroj këkundjen e një kurore peme,  
Përkunden nga era gjethet valë-valë,  
Rrënjët gëzimmëdha të asaj peme mendoj. . .

4

Një vajzë tej lisave merr buz' mbrëmjes,  
Tani e pashë hënën të gjysmuar,  
Gjer buz' me agun s'mund ta pushoj këngën.

## NJË BUZËMBRËMJE

*tek varri i nënës sime*

Mblidh e mblidh lule  
Tek lëndina aty pranë,  
Gjendet tufë lulesh  
për të zbrazur mallin tim?!

— Mëmë...Kaq ditë pa të parë,  
Të erdha me një frymë...

— Bir, do kesh djersitur,  
ndërro fanellën në darkë.

— Dhe këtu, moj mëmë,  
me merak?!

## ANTITRAFIKANTË

Jago.

Ndër drita semaforësh  
U tret  
Helmi i buzëqeshjes sate.

Humbi nëpër reklama  
Nepërka e pabesisë.

Mbi asfalte  
Rrëshqet ledhatimi yt  
Me thikën nën mëngë  
të xhaketës.

Otellon e droguan.

Shfaqja.  
U shty për nesër,

## DRITËRIMI I ATIJ ZËRI

*Tefta Tashko Koços*

Dëgjojmë zërin tënd  
E vetiu zënë çelin kajsitë,  
Fjala  
— pjalm' i lehtë nëpër ëndrra.

Mbrëmje e ag mbushen me dritë,  
Më shpejt na rreh zemra.

Dhe kokrriz' e rërës,  
Jetën ka brenda.

## PËR TRIMIN MUHAMET GJOLLESHA

Ai sheh agimin e sapopërflakur.  
Buzagazi buzë litarit,  
Këngë e lashtë  
                    spërkatur me dritë gjaku...  
Vjen një heshtje-bajonetë,  
Jo si heshtja e vdekjes.

Muhamet Gjollesha përkundet lehtë  
Dhe nis të ecë.

Të eci...

## NGJASHMËRI

Në çdo skaj të dheut cicërijnë zogjtë,  
Merren vesh e bisedojnë njëlloj,  
Ngaherë  
e njëjtë cicërima.

Gjuha e njerëzve —  
gjuha e zogjve,  
dhe të veçanta  
Dhe me një ngjashmëri të habitshme.

Për mua,  
Ndryshe,  
Diçka më ndryshe  
Cicërijnë zogjtë në vendlindje! ...



## MËNGJESI NISI UDHËN E VET

1

Te shteg' i udhës ndaluan të dashurit,  
Kroi thotë të njëjtat fjalë,  
Bulkthi vazhdon po atë këngë.

2

Tej pemëve t'afërta një bregore mali,  
Pyll' i dendur me cicërima që s'reshtin,  
Noton mbi kodër një re e bardhë e vogël...

3

Themi gur dhe na shfaqet bardhësia,  
Themi fortësi e kujtojmë gurin,  
Po, këta gurë kështu, të murrmë — ç'thonë?

4

Në brinjë të malit një lëndinë e vogël  
Me një stan delesh të bardha në prehër,  
Vijnë e ikin lartësive zogjt' e shkëmbit.

5

Të qetësoj mëzin e mallit po përpiqem,  
Gjuhën e gjetheve nxit pakuptuar era,  
Më harrakat nga mëzat dhe nga era nuk ka.

## VEGIME TË NGAHERSHME

1

Kaluan 30 vjet,  
Të dy  
të thinjur.

E kam të pashlyer buzëqeshjen tënde,  
Kushedi sa herë  
ndër ëndrra të kërkoj.

Ti tash s'ia tërheq kujt vëmendjen,  
Po unë të dua njëlloj.

2

Një kujtim që rrinte heshtur,  
Ç'më pruri kjo udhë.

Çelka dhe në dimër petale dashuria.

Ajo dritë e ndezur ku prisja dikur...

O, hën' e bardhë

e vegimeve të mia...

3

Ti ishe sykaltër,

Kaltërsinë q'ahere e dua shumë në jetë.

Ata sy gjith' dritë...

Pa u takuar tridhjetë vjetë.

Po ka viti ditë

Kur prapë buzagaze tek pamja ti më je.

S'di si ndodh që vjen e brishtë dhe e re.

4

Ra bora e re sipër borës së vjetër.  
Jemi larg të dy.  
Për borën e re mund të meditojë ndonjë  
tjetër,  
Unë, kurrsesi.

## SHQIPTARI

I preke gazin,  
                    në çast verbohet.  
I preke dritën,  
                    vrehet me nxitim.  
I preke këngën,  
                    plaket para kohe.  
I preke lirinë,  
                    shkrepëtin.

Pas shkrepëtimës, rrufeja.

Rrufeja! ...

## PRANVERË

Dallëndyshja nga buz' e blerimit  
Lulebajame më bie mbi bebëz...

Një vajzë prashit ullinj.

Ik e cja zogu mes erës...  
I harrova syt' e mi.

— Pas zemrës...

## NJË IKJE GJËMIMRËNDË

*Ali Pashë Tepelena*

### 1. APOLOGJI

Ka lezet kur qesëndin  
Vdekjen, rrethuar taborrë;  
Moj kalaja në Janinë,  
Je kala e prapë gulçn...

Frymë kam dhe për dy fjalë,  
Mbase do më kenë vlerë;  
«Ia këndon vetes fermanë,  
Pcrt' e Lartë, moj Port' e zezë...»

Një patllake paç kur leva,  
Radhë-radhë ia numërova;  
Gjakun tim e pinë kështjellat,  
Ndaj s'e lanë aq kollaj lloha...



Dua të dal në ujdhesë,  
Nga ky kurth dua të brof;  
Jam nga rracë që s'më qerdhes,  
Portë, moj e nxira portë!...

## PREHJE

Në sini të vate koka,  
Që s'tu praps nën presë palle;  
Po dhe prerë copa-copa  
Shitje drithmën ndër divane...

...Daltove kala me derte,  
Mbi pllak' varri përherë brymë;  
Prehesh mbi dy kontinente,  
Ali Tepelena ynë...

Ti na ike gjëmim rëndë,  
Jehonën që s'shuhet le;  
Le lavdi, po nuk le këngë,  
I pavarri në atdhe!...

## NIS PIKON NJË SHI I HOLLË...

Nis një shi  
I hollë, i hollë,  
Sikur frymë e lehtë të jetë;  
Gjethja  
Faqen vë mbi mollë,  
Shi i butë që s'lag vërtet...

Nxiton hapin  
Vetullhëna,  
Buzagaz ç'e pret një djalë;  
Brof një trumbë  
Me mëllenja,  
Mall' i zemrës flet pa fjalë...

Frut' i pemës  
Pikon mjaltë,

Djali hesht e vajza s'flet;  
Zën' përkulen,  
Çiken pakëz  
Dhe si pemët dridhen lehtë...

— Vesë stinë a  
ç'të jetë?!...

## PREHJE

Udhë

dhe udhë...

Nuk sosin kurrë

këngët,

ëndrrat,

dashuritë...

Po një ditë

Vjen largimi.

Për dëshmorët,

I harruar

harrimi.

## NË SHKOLLËN KU MËSOVA ABETAREN

*mësuesit tim të klasës së parë*

Prag' i dhemshur ku tinguj të blertë për-  
kunden,  
Vërshim' i kujtimeve që s'njohin kurrë  
pengesën;  
Gjuha e gurëve dhe gjuha e luleve,  
Ëndrrat e fëmijënisë spërkatur me vesë...

Korridori, klasat... prit e përcill kaq vjet,  
Buzagazi plot dritë që s'di njëherë të ndalur;  
Edhe sot,  
edhe sot që je zbardhur krejt,  
Rrezëllon ngrohtësi një zë i dashur...

Në qiellin e mallit tringëllin zilj' e kujtesës,  
Ti sheh ledheve të një krenarie që s'shteron;  
Ai vështrimi yt rrafshon kreshtën e harresës,  
Bletë drejt kosheres së gëzimit  
— tek ti vijmë gjithmonë...

...Shteg' i oborrit bujisur blerim dhe buz'  
shqote,  
Ik e eja një gushëkuq, herë shirash, herë flla-  
deve;  
Ai gushkuq  
mos është' buzëqeshja jote?  
Mall' i ish-nxënësve.  
apo A-ja n'abetare? ...

## BLIRI

Ulur pranë me blirin shohim yjet,  
Hesht ky bli i ndrydhur në kujtime;  
Po ç'mendon, e dashur, ç'janë meraket  
Kur pranë buzës ndien veç buzën time?

Ndër reflekse dridhen yjt' e largët,  
Fle ky bli i ndrydhur në kujtime;  
Ti mbështet dy supet tek parmaku  
Dhe ngadal' merr afër kokën time...

Ç'vlerë kanë elozhet e premtimet  
Pranë një bliri ndrydhur në kujtime?  
Ka në jetë halle, gaz e derte,  
O, sa shumë të thotë kjo puthja ime...



Cila është në botë ëndrra më e bukur,  
Krah një bliri ndrydhur në kujtime?  
Ndille ti, e dashur, do ta gjesh,  
Gjersa ndien kaq afër

frymën time!...

## REFREN I NËNAVE TË DËSHMORËVE

- Ku e mori plumbi?
- Sisën hallall, ballin plot nder.

M'e fuqishmja e poezive që s'gjendet  
gjëkund:  
«— Ka nëna djem të tjerë...»

## NË NJË DITË TË VRENJTUR

Figura poetike kërkova shpesh,  
Mikes t'ia kushtoja ndër poezi;  
Le të flasim hapur — ajo e vlen,  
Po prapë... i lexonte ngaherë me mërzi.

Një ditë të vrenjtur ecte menduar n'udhë,  
Duhej gjetur një krahasim i ri;  
— Si një diell dole!

— i thashë unë,  
Ajo afroi buzët. Binte shi...

NË SHTËPINË E PUSHIMIT  
NË VLORË

Kjo palmë... po ajo,  
Rritur kaq shumë limonat,  
Bredhat,  
Çdo pemë.

Të kam kërkuar unë.  
Ësht' e mundur  
Në ëndrrat e tua  
të mos jem?

Qielli dhe deti.  
Po ata zogj,  
Zogj si ata dikur...

Midis dy kaltërsive  
Zogjtë morën vrull.

Sytë nëpër petale,  
Kjo mbasdite m'i humbi.

Kaq shumë lule  
Po ato tonat  
s'i shoh gjekundi...

## PYLLI NUMËRON DITËT

1

Një vajzë tej lisave merr buz' mbrëmjes,  
Tani e pashë hënën të gjysmuar,  
Gjer buz' me agun s'mund ta pushoj këngën.

2

Në fund të malit një kodër e vogël  
Me një stan delesh në prehër,  
Vijnë e ikin lartësive zogjt' e mbrëmjes.

3

Po ajo arrë me hijen që humbet pakuptuar,  
Brezat nën degët e saj ndërruan jetë,  
Nga vit ajo ndërron e hedh gjethet sipër tyre.

4

Mbrëmja përcjell ditën me hijen e pemëve,  
Hieja e pemëve puth mbrëmjen që po ikën,  
Në gjethe pemësh pylli numëron ditët që do  
vijnë.

## AI PËRSËRI MENDON ME NGJYRA

*Abdurrahim Buzës*

Dora e lodhi penelin,  
Peneli e çlodhi dorën.

Një jetë të tërë  
lodh penelin,  
çlodh dorën  
e ngroh pareshtur zemrat tona.

Vajti të qetohet  
lodhja.

Ja, këtë sikur na thotë  
Dhe ajo e kuqërremta ndër tablora...



## BUZË ME DETIN

Kohë e njëtrajtshme,  
Vjetërohet çdo gjë.

Nja dy gjurmë  
S'i gjetkam dot.

S'po kërkoj më,  
Mjaft, për sot.

Brigjet po ato,  
Valë në nxitim.

Rrjedhë e një kohe  
Që ikën pa kthim.

## PREHËR I DHEMBSHUR

Ligjërime nënash,  
ç'na e ngrohni kaq gjirin,  
Ligjërime rrahur ndër duhmë thëllimi;  
Ato thinja që mallin dot s'na thinjin,  
Ato ninulla që na çelën syrin...

Pranë me ju dhe qielli na bëhet shteg,  
Biem në mendime sa herë ju kemi larg;  
Dhe burim  
dhe det,  
Të mbrujturat merak.

Nëna ime  
këngë,  
prehër,  
prag!...

## MËNGJES VJESHTE

Drejt shtigjeve panumër të ditës,  
Hap' e mbyllu qetaz  
qerpikët e dritës.

Dita u zgjua nga dor' e pakuptuar.  
Shiu zë pikon përmbi hardhi.

Uji i strehëve s'di të pushuar,  
Ftoi në vresht ma bën me sy.

Vjeshtë, moj vjeshtë,  
je stinë  
a je magji?!...!



## UNË DHE AJO

1

Humba pas yjeve...  
Ai zogu i dy syve të saj  
Më hyri në zemër.

Yjet...  
Dhe hën' e bardhë,  
E atij vështrimi t'ëmbël...

2

Lulet e një kumbulle bien mbi ugarë.  
Ndanë shtegut u ndodhëm  
Dhe ecim pranë e pranë.

Nga frym' e saj  
Një petale zë të çelë...

T'i flas ca fjalë,  
Apo më mirë

i flet kjo pranverë.

## MALLI I BAJRONIT

Ra muzgu si legjendë  
Përmbi kodra,  
E unë ecja kaluar  
Me dy trima;  
Papritur, si gërshet i kaltër u shfaq Vjosa,  
Mes zajesh tërë feks e gurgullima. . .  
Mbi atë lumë  
Çlodh varkën e mendimit,  
Sa herë më brof  
Vegim' i një ndajnate;  
Ja. . . mjekrën bardhullore të Vezirit  
Më ngjan se e kreh lehtë pres' e një shpate. . .

Eh, ai buzagaz  
Kurrë s'di të reshtur,  
Bes' e nder të mbrujtur  
Për çdo hap;  
Me fustanella borë të bardha veshur,



Lashtësinë ilire thellë e ndiejnë në gjak.  
Si mundet ta harroj  
Ndër udhëtime,  
Një kreshtë të lartë  
Që ngrihej përkarshi;  
Ca lisa nëpër mjegull vezullimesh  
Më shkundin ballit dert e dhemshuri. . .

## DREJT VATRËS KU KAM LINDUR

Sapo dal tek Qaf' e Këndrevicës,  
Brufullon një zog,  
Frynë një e mirë  
erë,  
Lulebardha mbushet plot kjo udhë...

Për ku kam lerë,  
Rend më shpejt  
zogu,  
flladi  
apo unë?...



## PAMJE PREJ SHQIPONJE

*Heroit të Popullit Zylyftar Veleshnja*

Praps e shtyjë stuhitë,  
Zjarr përpiq tek sytë,  
fjala-gur' i rëndë.

Nuk e njohu çlodhjen,  
Pamje prej shqiponje,  
Kreshtës mbi një shkëmb.

Lindur për në këmbë,  
Nga mermer' i rëndë  
ngrihet të dalë brigjesh.

Shtirirë s'i paket malli,  
Një iso stralli  
e përcjell tej shtigjesh...

## FJALË QË NA I FSHEHU DETI

1

Ec e eja buzë valëve,  
E harrova veten.

Sipër rërës së detit,  
Gjenden dot gjurmët e dashurisë që pata?

Hapat duken të shkurtër  
Për të matur vitet e gjata.

Herë i bie vala leshterikët para,  
Herë i merr prapa.

Vala . . .

2

I kam fshehur thellë  
Ca fjalë dashurie të hershme,  
Si perlat që deti i fsheh  
e i nxjerr kushedi në ç'mot.

Rëra djeg këmbët po  
ç'djeg malli  
Nuk ka varg ta thotë...

Të desha shumë.  
Kërkoj dhe s'i gjej dot  
Fjalët që i thamë njëri-tjetrit.

Ndoshta, ngaqë u zumë ashtu kot,  
Na i ka fshehur deti.



## TAFIL BUZI TËRSËLLIMA

Hop e hop nëpër çdo majë,  
Si s'iu sos njëherë baruti?!  
Ja, nën lis tek sheh me mall,  
Tej e tej kodrat e Buzit...

Qetoi hapin Tafil Buzi.  
Shpatën e mpreh në një pllakë;  
Çlodhet kreshtës tek hauzi,  
Mes burimesh rreth e qark.

Atë shpatën presërendë,  
Feksur motesh me stuhi,  
E ngul pranë, t'i rrijë më këmbë,  
Se prapë do t'i japë veri...

Udhësh e betejash lodhur,  
E zu pakëz një dremitje;  
Pylli me lajthiza rrotull,  
Pushon krejt çdo pëshpëritje...

Bëri gjumë-e para herë,  
Në buz' shkëmbi ulur kokën;  
Vetëtima shkrep paprerë,  
Deshën s'deshën i folën shokët:

— Ngrehu, Tafil tërsëllima,  
Rrezj' e hënës honesh hyri;  
Çeli sytë e vetëtimat  
Prapsi tej me bisht të syrit...

## PAKËZ GJEOGRAFI

Tre male rrotull ka fshati im,  
Në vend të të katërtit —  
një haur i thellë me hone.

E hapur gryka shkëmbore,  
Për agun,  
mbrëmjen  
dhe atë yllin...

Nga lind dielli,  
Një dritare që veç na gëzon syrin.

E, as netëve  
s'na pëlqen ta mbyllim!...



«SHQIPTARJA»

*Tabloja e Kamil Koro, 9 janar 1872*

Atë ditë janari gjallërisht ecte peneli,  
Nëpër deje gjaku jeta merrte udhë;  
Dora e më muzikantit piktor francez,  
Shekujve u jepte  
tinguj mbi pëlhurë...

Pamja e një vendi  
e jo vajze të veçantë,  
Përmes një natyre burim drite e shqote;  
Dy sy të menduar të përcjellin gjer larg  
Me diçka nga isoja  
e kësaj toke...

## ZEMRËN KAM SI PROVË

*Aleksandër Moisiut*

Nga syt' e tij gjithë zjarr, përherë të ndritur,  
Një brengë e dhëmshuri derdhej mbi ballë;  
Në çaste gjallërie të papritur,  
Lëvrinte gjak' i pastër shqiptar.  
...Ja, fëmijni e largët shfaqet shpesh  
Me muzgjet e pashoq, dimrat me tufan;  
Afrohet te dritarja dhe mban vesh  
Mos bubullimat sjellin ndonjë lajm...

Ç'i dridhet një pikë loti nëpër sy,  
Siç dridhet vark' e vogël nga stuhia;  
— Po, eja bir, ç'po ndodh kështu me ty, —  
I flet prapë nën' e dashur Amalia...  
Si në pasqyrë magjike, ai sy s'e ndan  
Një kreshtë mali mbi detin e praruar;  
— Po ja, moj nënë, ky lot kërkon liman,  
Se pikon mall e malli s'di të shuar...



Ullinjtë e Ilirisë tundin degët,  
Një tis i kaltër derdhet në çdo skaj;  
Nga hije gërxhesh valëve të detit,  
Era, shkoi të çlodhet në lisnajë.

— Zembrën kam si provë, — thoshte nga-  
herë, —

Për mëmëdhenë ç'më prushëron një mall;  
Këtë dalldisje shpirti dallgëgjërë  
E kam nga ato brigje... Jam shqiptar!

## NJË NËNË PARTIZANE

Tek ledhi mbi fshat  
Ndrin drit e kandilit;  
Një nënë, ballin lart  
I hedh kupa birit.

Trok dera pas pak,  
Tjetër i plagosur;  
Nëna krahët hap,  
Bora s'di të sosur...

Nga një cefël predhe,  
Thellë një plag' e rëndë;  
Nëna merr «melhemet»,  
— Bir, të pastë kjo nënë!

...Ju, o nënat tona,  
S'u lodhët ndopak;  
Ju që na mjekoni  
Gjith' dert e merak...  
Balsam' i çdo plage,  
Mjekim i çdo nëne;  
Dhe me fletë mullage,  
Dhe me rrënjë shpëndre...

Ku ta njihnin nënat  
Vallë kirurgjinë?!  
Po, çdo rrahje zemre  
Nëna e sheh mirë.

Kupton shqetësimet,  
E ndien thellë çdo dhimbje;  
T'i lëçit mendimet,  
Pse thonë — zemër nëne!

## PAS KAQ VITESH

S'më harrohet në vegjëlinë time  
një lejlek,  
Me folenë maj' vidhit aty në breg,  
Kur afronte mbrëmjeve me një kashtë në  
sqep,  
Ne vraponim ta përcillnim shteg më shteg.

Mëngjeseve ikte me pëshpërime tek sqepi.  
Frëpurima i mekej si nanurisje gjethi,  
Me atë çerdhen e ngrohtë  
të mallit në gji,  
Një shtegtim të largët na ravijëzonte ndër  
sy...

Ja vidhi...

Po ai,

ku të jetë ai?!

## PAS SHIUT

Shiu sa pushoi. Po eci trotuarit,  
Miliarda lot qerpikëve të mimozës...  
E zgjata dorën të këpus një degëz,  
Po dhjetra lot m'u derdhën pardesysë,  
Siç derdhet uji nga rrot' e një mulliri...

Dhe qeshën gjimnazistet prapa meje,  
E unë s'arrita degëzën ta merrja,  
Ndaj ula kokën, ika vetullngrysur.

Ëmbëlsi' e buzëqeshjes gjimnaziste  
Më thante supesh lotët e mimozës...

## UJI I FTOHTË NË TEPELENË

Fjala lëviz ajrin,  
Ajri gjallon fjalën.

Me frymë të lehtë veriu  
Vijnë  
E s'kanë të ikur  
                    mëngjeset.

Si prarim' i vesës  
Që bulon vetiu  
Në petale gjethesh.

## MËNGJESI I DITËS SË TRETË

Mëmë,  
Në parvazin e dritares ku ti vure saksinë  
Një zogu,  
S'ia kuptoj dot tërë ato ligjërime...

Me pëshpërimë,  
Marr e jap t'i themë qoft' me dy fjalë,  
Ëndrrën e mbrëmshme kur më vure dorën  
në ballë.

Mëma ime...

## DËSHIRË

Çdo hije peme ka vetiu bukuri,  
Po, me të kaptuar dielli,  
Si ulliri

s'mund ta ketë hijen asnjë pemë.

Ajo freskia e së blertës...

Në s'qofsha i zoti një rreze drite të jem,  
Paça hije si ulliri

gjer në mbrëmjen e jetës.



## PËRMBAJTJA

Gjeneza e këngës .....	3
Përroi .....	4
Të kisha pritur ty .....	5
Çmalije .....	6
Tregim i një nëne për luftën .....	7
Zambakët e lirikave .....	8
Qielli .....	11
Stina e jetës .....	12
Kroi i vetmuar ndanë xhadesë .....	13
Lirikat e liqenit .....	16
Pranverë e vonuar .....	17
Trimëresha Maro Konda .....	18
Tre vëllezërit Frashëri .....	20
Mot i vrenjtur .....	21
Dëshmori që ra në ditën e çlirimit .....	22
Ku ta kërkoj? .....	24
Nëna e dëshmorëve Lef e Mitaq Sallata ...	25
Gjithkush gëzohe! .....	26
Marrëveshje .....	27
Për këto troje .....	28

Buzë me mbrëmjen .....	30
Kjo udhë nëpër natë .....	31
Në këtë mëngjes të freskët .....	32
4 shkurt 1944 .....	33
Nuk mund ta pushoj këngës .....	34
Një buzëmbremje .....	36
Antitrafikantë .....	37
Drithërimi e atij zëri .....	38
Për trimin Muhamet Gjollesha .....	39
Ngjashmëri .....	40
Mëngjesi nisi udhën e vet .....	41
Vegime të ngahershme .....	43
Shqiptari .....	46
Pranverë .....	47
Një ikje gjëmimrëndë .....	48
— Apologji .....	49
— Prehje .....	50
Nis pikon një shi i hollë .....	51
Prehje .....	53
Në shkollën ku mësove abetaren .....	54
Bliri .....	56
Refren i nënave të dëshmorëve .....	58
Në një ditë të vrenjtur .....	59
Në shtëpinë e pushimit në Vlorë .....	60
Pylli numëron ditët .....	62
Ai përsëri mendon me ngjyra .....	64
Buzë me detin .....	65
Prehër i dhembshur .....	66
Mëngjes vjeshte .....	67
Unë dhe ajo .....	68
Malli i Bajronit ....	70

<b>Drejt vatrës ku kam lindur .....</b>	<b>72</b>
<b>Pamje prej shqiponje .....</b>	<b>73</b>
<b>Fjalë që na i fshehu deti .....</b>	<b>74</b>
<b>Tafil Buzi tërsëllima .....</b>	<b>76</b>
<b>Pakëz gjeografi .....</b>	<b>78</b>
<b>Shqiptarja .....</b>	<b>79</b>
<b>Zemrën kam si provë .....</b>	<b>80</b>
<b>Një nënë partizane .....</b>	<b>82</b>
<b>Pas kaq vitesh .....</b>	<b>84</b>
<b>Pas shiut .....</b>	<b>85</b>
<b>Uji i ftohtë në Tepelenë .....</b>	<b>86</b>
<b>Mëngjesi i ditës së tretë .....</b>	<b>87</b>
<b>Dëshirë .....</b>	<b>88</b>